Podujevë, datë: 05.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 1

z.Vigan Salihu, me kualifikim MSC Fakulteti i Agrobiznesit (Ekonomi e Bujqësisë) nga fshati Dumnicë e Poshtme-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit ekonomik**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit ekonomik do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-112/02-0078705/25
Podujevë, Dt: 05.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. Valon Potera, auditor i brendshëm në Njësinë e Auditimit të Komunës së Podujevës **AUTORIZOHET** për kryerjen e të gjitha punëve dhe detyrave përfshirë nënshkrimin dhe procedimin e dokumentacionit në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësiive ligjore të Njësisë, konform Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

Neni 2

Autorizimi sipas nenit 1 të këtij vendimi vlen deri në rekrutimin e përgjegjësit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-112/02-0078703/25
Podujevë, datë: 05.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 13 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/0050862/18, merr këtë:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

- I. Pezullohet sipas detyrës zyrtare marrëdhënia e punës e Haki Rudari mësimdhënës i lëndës biologji në SHFMU “Hasan Ramadani” Shajkoc, SHFMU “Pavarësia” Siboc dhe SHFMU “Shaban Shala” Podujevë, duke filluar nga data e dhënies së Betimit më 01.12.2025 si anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.
- II. Pezullimi vlen për kohëzgjatjen e mandatit si anëtar i Kuvendit të Komunës, ose deri në përfundimin /shuarjen e mandatit sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Gjatë periudhës së pezullimit Haki Rudari gëzon të drejtat sipas Ligjit për Zyrtarët Publik në fuqi, përfshirë ruajtjen e vendit të punës, pa pagesë nga institucioni ku është punësuar.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit.

Arsyetim

Haki Rudari mësimdhënës i lëndës biologji në SHFMU “Hasan Ramadani” Shajkoc, SHFMU “Pavarësia” Siboc dhe SHFMU “Shaban Shala” Podujevë është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës nga zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, ku i njëjti ka paraqitur kërkesë nr. Prot.02-118/02-0078624/25, datë 05.12.2025 për pezullim të marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare, në institucionet arsimore.

Sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht neneve **69 paragrafi 1.2 , 71 dhe 86.2** të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pas dhënies së betimit si anëtar i Kuvendit të njëjtit i pezullohet marrëdhënia e punës si mësimdhënës, pa pagesë sipas detyrës zyrtare, me qëllim të ushtrimit të mandatit si anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Pas përfundimit të mandatit si anëtar i Kuvendit i përmenduri kthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Nga se u cek u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankese në Komisionin komunal të ankesave brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me këtë vendim njoftohen:

Haki Rudari
Drejtoria e Arsimit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-118/02-0078667/25
Podujevë, datë: 05.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT** **Nr.prot.02-020/04-0075426/25 të datës 19.11.2025**

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr.prot. 02-020/04-0075426/25 të datës 19.11.2025, Për Ngritjen e Komisionit AD-HOC Për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve në projektin “Përkrahje me Mëshqerra” dhe atë në përbërje të komisionit aktual shtohen edhe dy anëtarë si në vijim;

- **Rilind Mehanja**, specialist i IT - DKA
- **Ilir Abdullahu**, punëtor zërimi – DKRS

anëtar
anëtar

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërse e vendimit nr.prot.02-020/04-0075426/25 të datës 19.11.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Të caktuarve..
Kryesuesit të komisionit.
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
QSHQ/Arkivit.

Nr. Prot 02-020/04-0078988/25
Podujevë, datë 08.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË ARSIMIT**

Neni 1

z. Avni Fetahu, MSC i shkencave ekonomike, nga fshati Shtedim, Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-112/02-0079393/25
Podujevë, datë: 09.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040 nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 parag. 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/SHËS TË DREJTORISË SË** **SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

Neni 1

znj.Lirie Hoti Rama, me kualifikim Bachelor Gjuhë Angleze, Bachelor juridik, Master në Fakultetin Juridik-Divizioni Civil dhe Provim të Jurisprudencës, nga fshati Bradash-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtruese e Detyrës së Drejtoreshës të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Neni 2

E përmendura punët dhe detyrat e punës do t'i ushtrojë përkohësisht deri në emërimin e drejtorit/shës të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-112/02-0079396/25
Podujevë, datë: 09.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 11 paragrafi 1 dhe 17 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027 nr.prot.01-401/01-0065086/24, dt.26.09.2024, në rekomandim të datës 08.12.2025 të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0067780/25, datës 21.10.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, sipas Ftesës Publike nr.prot. 15-300/01-0062661/25 të datës 26.09.2025, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e tridhjetë e tre (33) përfituesve me 56 pajisje pune, në Komunën e Podujevës.

2. Mbështetja financiare bëhet sipas kushteve dhe kriterëve sipas Ftesës publike për aplikim në projektin *“Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve përkatësisht subvencionimi në vlerë totale 47,050 € €, nga e cila 70% apo 32,935 € financim nga Komuna, ndërsa participimi i përfituesve bëhet në vlerë 30% për një përfitues apo 14,115 € të shumës së investimit të përcaktuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.*

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bizneseve ekzistuese dhe bizneset Start Up në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesëve të përzgjedhur për implementimin e projektit: *Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve*, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për realizimin e subvencionimit lidhet marrëveshje/kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat në mes Komunës dhe përfituesit të subvencionit.

Neni 5

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim me Komisionin përkatës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-400/03-0074590/25
Podujevë, datë: 10.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 02.12.2025 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej tremijepesëqind euro (3,500 €), ndihmë për shtatëmbëdhjetë (17) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin dhjetor 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/04-0079642/25
Podujevë, datë 10.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, në Kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 11.12.2025, merr;

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E SPORTISTIT TË** **VITIT 2025 NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

Neni 1

Për përzgjedhjen e sportistit të dalluar të vitit 2025 në Komunën e Podujevës ngritët komisioni në këtë përbërje;

Vehbi Kastrati,	kryesues
Ismail Krasniqi,	anëtar
Feride Kastrati,	anëtare
Blertë Kaçi,	anëtare
Enver Cakiqi,	anëtar

Neni 2

Komisioni bënë vlerësimin e propozimeve / nominimeve të Klubeve Sportive në bazë të sukseseve dhe rezultateve të arritura në gara vendore dhe ndërkombëtare dhe bënë përzgjedhjen e sportistit të dalluar për vitin 2025 në Komunën e Podujevës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS.

Anëtarëve të Komisionit, përmes DKRS-së.

QSHQ/Arkivit.

Nr.prot 02-020/04-0073881/25
Podujevë, datë, 11.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.pot.02-020/04-0079698/25 të datës 11.12.2025, nxjerr;

V E N D I M

Neni 1

Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve të krijuesve në aktivitetin letrar ***Takimet e Kulturës "Kadri Kadriu" – 2025***, në fushat; ***Poezi, Ese dhe Tregim i Shkurtër***, sipas konkursit letrar të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, publikuar më 21.11.2025, formohet komisioni në këtë përbërje:

- **Vjollca Haliti Breznica**, profesoreshë e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - kryesuese
- **Majlinda Deda**, shkrimtare - anëtare
- **Avni Çunaku**, shkrimtar - anëtar

Neni 2

Komisioni bën vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve letrare në fushat sipas këtij vendimi në përputhje me kriteret e konkursit përkatës, si dhe përgatit informatë në formë të shkruar të cilën i'a paraqet Zyrës së Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet;

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së

QSHQ/Arkivit

Nr.Prot: 02-020/04-0079880/25
Podujevë, datë: 11.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13, 58 shkronja (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenet 14, 16, 59 paragrafi 3.1 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18,merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Leonora Dërvisholli, lirohet nga pozita e zyrtares administrative në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Podujevës

Neni 2

Lirimi nga detyra e zyrtares sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet në kërkesë të të përmendurës, për arsye personale.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurës
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-118/02-0080544/25
Podujevë, 16.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 58 shkronjat b) dhe g), 60.3 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 4 paragrafët 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) 03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna dhe nenet 14, 61 paragrafët 1.2) 1.7) dhe nenin 63.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

I.

Autorizohet z. Fahri Restelica, Nënkyetar i Komunës së Podujevës, që në mungesë eventuale të Kryetarit të Komunës, të ushtrojë funksione ekzekutive dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës.

II.

Ushtrimi i funksioneve ekzekutive sipas pikës I bëhet në koordinim dhe konsultim paraprak me Kryetarin e Komunës.

Nga një kopje e Autorizimit i dërgohet:

- Nënkyetarit të Komunës
- Drejtorëve të Drejtorive (për njoftim)
- Zyrës së Personelit
- QSHQ/Arkivës

Nr.Prot. 02-112/02-0080547/25
Podujevë, dt: 16.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Ligjin nr.04/l-022 për përdorim civil të eksplozivëve, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë **PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE**

I

NDALOHET përdorimi i mjeteve piroteknike/eksplozivëve në sheshe, rrugë, tregje dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Podujevës.

II

Ndalesa sipas pikës **I** të kësaj Urdhërese vlen për periudhën 22 dhjetor 2025 deri më 03 janar 2026.

III

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.

IV

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Inspektionit
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0081342/25
Podujevë, datë: 22.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. prot.01-020/01-0050862/18, dhe konform Ftesës Publike nr. prot. 15-300/01-0080396/25, të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, të publikuar më 16.12.2025, nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e shtëpizave të drurit sipas Ftesës Publike të DPZHE për projektin **“Ditët e Fund Vitit 2025”** që ka për qëllim rritjen e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese me rastin e festave të fund vitit dhe fluksit të ardhjes së mërgimtarëve, ku do të ofrohen shërbime të gastronomisë dhe artizanate dhe të natyrës së ngjashme sheshet: “Dëshmorët” dhe “Ali Ajeti” në Podujevë, ngritet komisioni, në përbërje:

Ejup Babatinca, kryesues
Donjeta Potera, anëtare
Genc Gashi, anëtar

Neni 2

Komisioni, bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe për zgjedhjen e aplikantëve / bizneseve që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në shtëpizat e drurit në sheshet sipas projektit të publikuar me Ftesën Publike.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0081645/25
Podujevë, datë: 22.12.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës, ngritët komisioni në këtë përbërje:

Ardian Emini, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit,

Ardonis Jusufi, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave

Xhyfidane Nimani, zyrtare në Drejtorinë e Administratës,

Albana Haxha Berisha, zyrtare në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave,

Ilirian Duriqi, zyrtar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF,

kryesues

anëtar

anëtare

anëtare

anëtar

Mandati i komisionit është dy (2) vite.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregullore MF-nr.03/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.02-020/04-0082156/25
Podujevë, dt: 24.12.2025





KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVO		
DREJTORIA E ARSIMIT / ŠKOLNA UPRAVA / DEPARTMENT OF EDUCATION		
Dërguar më Dostavljeno	26.12.2025	
Nr. Org. sed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-463/06-0082566/25		
PODUJEVO - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 4 dhe 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, nenit 97 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me Hartën Zonale të Komunës së Podujevës (HZK) për periudhën 2022-2030, e miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. Prot. 01-020/02-0030654/22, datë 29 prill 2022, në kërkesë Nr. Prot. 02-464/01-0022232/24 datë 05 prill 2024 të Drejtorisë së Arsimit merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

Neni 1

Miratohet shpronësimi i objekteve në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim detaj të paluajtshmërive, si në shtojcë të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik, realizimin e projektit "Ndërtimi i Çerdhes"

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrale dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Arsimit që brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi të njëjtin t'ua dërgojë pronarëve ose zotëruesve të interesit në pjesë të pronave të paluajtshme të cilat preken me realizimin e projektit, dhe brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, i njëjti shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Neni 3

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave që brenda afatit prej dy (2) vite, të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të objekteve të shpronësuara, të përcaktuar në Aktin e vlerësimit nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave (shkresa nr. prot. 184-3/2025 dt 01.09.2025) i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi, secili pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose në të drejtat pronësore që janë objekt i këtij vendimi përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtpërdrejt në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, kanë të drejtë ankese në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr.03/L-205.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Arsimit.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij, vendim i cili paraqet bazë juridike për regjistrime në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Pronarëve ose zotëruesve të interesit
- QSHQ/Arkivit


Nr.prot. 02-463/06-0081566/25
Podujevë, datë: 26.12.2015

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi



Nr	Emri mbiemri i pronarit ose zotëruesit	Nr.i pjesës së ndërtesës	Lloji i shfrytëzimit	Zona Kadastrale	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja e pjesës së ngastres për shpronësim m ²
1	Fatmir (Hysen) Stublla (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-7-0	Lokal	Podujevë	114	114
2	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-6-0	Lokal	Podujevë	344.1	344.1
3	Fatmir (Hysen) Stublla (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-5-0	Objekte te tjera	Podujevë	6	6
4	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-4-0	Lokal	Podujevë	134.86	134.86
5	-Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-3-0	Lokal	Podujevë	45.08	45.08
6	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-2-0	Lokal	Podujevë	241.8	241.8
7	Blerim (Avdyl) Jakupi Nerxhivane(Fehmi) Jakupi Me nga 1/2 (qirambajtje 99 vite)	2153-1-121-1-1-0	Lokal	Podujevë	110.05	110.05

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Avni Fetahu



Drejtorë të PSPK-së
Saranda Stublla





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58.b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 si dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIMIN E ARKËS TË** **KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN FISKAL 2025**

Neni 1

Për regjistrimin e arkës të Komunës së Podujevës për vitin fiskal 2025, ngritet komisioni në përbërje:

Rilind Babatinca,	kryesues
Ardonis Jusufi,	anëtar
Jehona Zhjeqi Murati,	anëtare

Neni 2

Komisioni më 31.12.2025 bën regjistrimin e arkës dhe Zyrës së Kryetarit të Komunës përmes drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i paraqet raport në formë të shkruar.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0083661/25
Podujevë, datë: 31.12.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat Publik, nenin 13 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat Publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/0050862/18, merr këtë:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

I. Pezullohet sipas detyrës zyrtare marrëdhënia e punës e Qëndresë Hajrizi, sekretare në SHFMU "Hyzriu e Samiu" në fshatin Letanc, Komuna e Podujevë, duke filluar nga data e dhënies së Betimit më 29.12.2025 si anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

II. Pezullimi vlen për kohëzgjatjen e mandatit si anëtare e Kuvendit të Komunës, ose deri në përfundimin /shuarjen e mandatit sipas legjislacionit në fuqi.

III. Gjatë periudhës së pezullimit Qëndresë Hajrizi gëzon të drejtat sipas Ligjit për Zyrat Publik në fuqi, përfshirë ruajtjen e vendit të punës, pa pagesë nga institucioni ku është punësuar.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit.

Arsyetim

Qëndresë Hajrizi, sekretare në SHFMU "Hyzriu e Samiu" në fshatin Letanc, Komuna e Podujevë është zgjedhur anëtare e Kuvendit të Komunës nga zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, ku e njëjta ka paraqitur kërkesë nr.Prot.02-016/01-0082935/25, datë 29.12.2025 për pezullim të marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare, në institucionin arsimor.

Sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht neneve **69 paragrafi 1.2 , 71 dhe 86.2** të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrat Publik, pas dhënies së betimit si anëtare e Kuvendit të njëjtës i pezullohet marrëdhënia e punës si sekretare, pa pagesë sipas detyrës zyrtare, me qëllim të ushtrimit të mandatit si anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Pas përfundimit të mandatit si anëtare e Kuvendit e përmendura kthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Nga se u cek u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankese në Komisionin komunal të ankesave brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me këtë vendim njoftohen:

Qëndresë Hajrizi

Drejtoria e Arsimit

QSHQ Arkiva

Nr.prot.02-110/03-0083692/25

Podujevë, datë: 30.12.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/0050862/18, merr këtë:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

- I. Pezullohet sipas detyrës zyrtare marrëdhënia e punës e Abedin Zeka, vozitës në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Podujevës, duke filluar nga data e dhënies së Betimit më 29.12.2025 si anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.
- II. Pezullimi vlen për kohëzgjatjen e mandatit si anëtar i Kuvendit të Komunës, ose deri në përfundimin /shuarjen e mandatit sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Gjatë periudhës së pezullimit Abedin Zeka gëzon të drejtat sipas Ligjit të Punës në fuqi, përfshirë ruajtjen e vendit të punës, pa pagesë nga institucioni ku është punësuar.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Administratës.

Arsyetim

Abedin Zeka, vozitës në Drejtorinë e Administratës të Komunës së Podujevës është zgjedhur anëtar i Kuvendit të Komunës nga zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, ku i njëjti ka paraqitur kërkesë nr. Prot.02-118/02-0083004/25, datë 29.12.2025 për pezullim të marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare, në Drejtorinë e Administratës.

Sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht nenit 41 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, pas dhënies së betimit si anëtar i Kuvendit të njëjtit i pezullohet marrëdhënia e punës si vozitës, pa pagesë sipas detyrës zyrtare, me qëllim të ushtrimit të mandatit si anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Pas përfundimit të mandatit si anëtar i Kuvendit i përmenduri kthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Nga se u cek u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankese në Inspektoratin e Punës brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Më këtë vendim njoftohen:
Abedin Zeka
Drejtorja e Administratës
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-110/03-0083697/25
Podujevë, datë: 31.12.2025

